



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



AKPA Agjencia
Kombëtare
e Punësimit
dhe Aftësive

DREJTORIA E NDIHMËS
JURIDIKE FALAS

Nr. prot. 349, Tiranë, më 29.01.2026

Nr. 2454/1 prot. Tiranë, më 29.01.2026

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS

DHE

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

« Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas, sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017 « Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti »

Sot, më datë 29.01.2026 lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Palëve:

- Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, me adresë: Rr. "Jordan Misja", Godina nr.3, Njësia bashkiake nr.9, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtor i Përgjithshëm (Në mungesë) Drejtori i Drejtorisë së Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Parësore, **Znj. Patricia Pogaçe**, këtu e në vijim « *Drejtoria* ».

Dhe

- **Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA)**, me NIPT: **K51731007D**, me adresë: Bulevardi "Bajram Curri" 1004 Tiranë, përfaqësuar nga z. Klevis Hysa, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm, këtej e në vazhdim cilësuar si AKPA.

Duke qenë se Palët,

Vlerësojnë rëndësinë e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti në kuadër të rritjes së aksesit në drejtësi për qytetarët si një parim themelor kushtetues.

Konsiderojnë se një ndër elementët kyç të aksesit në drejtësi është sigurimi i ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike të garantuara nga shteti në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive.

Marrin në konsideratë politikat e ndjekura dhe masat e ndërmarra në nivel legjislativ për të mbrojtur dhe garantuar ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Synojnë, implementimin efektiv të ligjit nr.111/2017 "*Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti*", bazuar në parimin e:

- a) aksesit të barabartë të individëve në ndihmën juridike;
- b) barazisë dhe mosdiskriminimit të individëve që gëzojnë të drejtën për ndihmë juridike;
- d) ruajtjes së konfidencialitetit;
- dh) shmangies dhe parandalimit të konfliktit të interesit;
- e) mbrojtjes së të drejtave të personave vulnerabël.

Konfirmojnë, angazhimin institucional për të siguruar standarte të larta dhe për të adresuar nevojat e subjekteve përfitues sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017.

Afirmojnë vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshje.

Kanë rënë dakord të lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi në vijim e quajtur *Marrëveshje*.

Neni 1
Baza Ligjore

Kjo marrëveshje bashkëpunimi bazohet në nenin 2, nenin 4 dhe nenin 8 të ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ligjin nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” i ndryshuar, ligjin nr. 145/2015 “Për Punëkërkuesit”, ligjin nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, VKM-në nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, i ndryshuar, si edhe VKM- në nr. 837, datë 28.10. 2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për ofrimin e shërbimeve të Punësimit” i ndryshuar.

Neni 2
Objekti

Objekti i kësaj marrëveshje konsiston në vendosjen e bashkëpunimit të dy institucioneve sa i përket shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti me qëllim ndërmarrjen e masave për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve dhe në veçanti të grupeve vulnerabël.

Neni 3
Qëllimi

Kjo marrëveshje synon përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet palëve, me qëllim forcimin dhe zhvillimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, përmes këtyre formave të bashkëpunimit:

- Promovimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, përmes realizimit të aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese, nismave të edukimit ligjor dhe shpërndarjes apo afishimit të materialeve të vizibilitetit;
- Shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira, me synim përmirësimin e politikave shtetërore në fushën e ndihmës juridike;
- Zhvillimin e takimeve dhe tryezave të përbashkëta për të diskutuar çështjet me interes të përbashkët;
- Planifikimin dhe organizimin e sesioneve informuese të përbashkëta në këtë kuadër;
- Kryerjen e analizave dhe studimeve të përbashkëta me qëllim nxjerrjen e rekomandimeve të karakterit ligjor dhe administrativ dhe vënien e tyre në dispozicion të palëve, të cilat do të vlerësojnë nevojën dhe formën e ndërhyrjeve konkrete bazuar në kompetencat ligjore.
- Referimin e rasteve për të përfituar ndihmë juridike parësore falas.

Neni 4
Angazhimet e palëve në Marrëveshje

I. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas merr përsipër:

1. **Të referojë punëkërkues** të cilët kanë nevojë të trajtohen dhe të mbështeten me shërbimet dhe programet e ofruara nga zyrat e punësimit, përfshirë regjistrimin si punëkërkues, këshillimin dhe orientimin në karrierë, si dhe përfitimin nga programet e nxitjes së punësimit.
2. **Të ofrojnë ndihmë juridike falas** për të gjitha rastet e referuara nga AKPA ose zyrat e punësimit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse.
3. **Të ndjekë dhe të monitorojë rastet e referuara** nëpërmjet pikave të kontaktit, me qëllim garantimin e një koordinimi të vazhdueshëm institucional ndërmjet palëve.
4. **Të bashkëpunojë me AKPA-n** në mbledhjen, analizimin dhe përditësimin e të dhënave, si dhe në evidentimin e rezultateve mbi rastet e referuara.

5. Të përcaktojë një pikë të dedikuar kontakti për koordinimin periodik me Zyrat e Punes, si në nivel vendor, ashtu edhe në nivel qendror.

II. AKPA merr përsipër:

1. Të sigurojë mbështetje institucionale dhe teknike në fushën e politikave të punësimit, arsimit dhe formimit profesional.
2. Të lehtësojë bashkëpunimin midis zyrave të punësimit dhe Drejtorive të Ndihmës Juridike Falas, me qëllim identifikimin, orientimin dhe përfshirjen e punëkërkesve nga grupet vulnerabël drejt shërbimeve të integruara të punësimit dhe aftësimit.
3. Të mbështesë dhe të krijojë lehtësirat e nevojshme institucionale dhe organizative për zbatimin efektiv të objektivave të kësaj marrëveshjeje, në përputhje me kompetencat funksionale të AKPA-s.
4. Të përcaktojë një pikë të dedikuar kontakti për koordinimin periodik me Drejtoritë e Ndihmës Juridike Falas, si në nivel zyre vendore, ashtu edhe në nivel qendror.
5. Të informojë mbi situatën e përfshirjes së grupeve vulnerabël në tregun e punës dhe në sistemin e arsimit dhe formimit profesional, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë mbrojtjen e të dhënave personale.
6. Të asistojë punëkërkesit e referuar që kanë nevojë për mbështetje në aksesimin dhe përdorimin e shërbimeve të punësimit.

Neni 5

Konfidencialiteti i informacionit dhe mbrojtja e të dhënave personale

1. Palët janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave personale apo informacioneve që do të trajtohen si konfidenciale nga të dyja palët në marrëveshje, përveç rastit kur palët me marrëveshje parashikojnë ndryshe.
2. Palët, gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, shkëmbejnë ndërmjet njëra-tjetrës të dhëna personale, në përputhje me ligjin nr.124/2024, datë 19.12.2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij.
3. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale dhe informacionit të shkëmbyer do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, duke marrë të gjitha masat e duhura organizative dhe teknike për ruajtjen e tyre.
4. Palët do ta përdorin informacionin e marrë vetëm me qëllin të ushtrimit të funksioneve të tyre ligjore.

Neni 6

Personat e kontaktit

Secila palë cakton një person kontakti, të cilit i drejtohen të gjitha komunikimet që lidhen me zbatimin e kësaj marrëveshjeje, qofshin ato verbale apo të shkruara, përfshirë komunikimet elektronike dhe ato në formë të shtypur.

Me qëllim sigurimin e një referimi sa më të saktë dhe efikas të rasteve, personat e kontaktit për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas do të jenë punonjësit e Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, duke qenë se ata realizojnë kontaktin e parë me kërkesit e shërbimit dhe janë në pozicionin më të përshtatshëm për të referuar drejtpërdrejt problematikat përkatëse, ndërsa për Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive do të jenë përgjegjësit e sektorit të ofrimit të shërbimeve të punësimit.

Për sa më sipër, personat e kontaktit për secilën qendër të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore janë:

Tiranë Punonjësi: Adela Zekthi adresa: Ministria e Drejtësisë email: ndihma.juridike@drejtesia.gov.al Cel: +355688534468	Elbasan Punonjësi: Arjan Bala adresa: Pranë prokurorisë Elbasan email: ndihma.juridike@drejtesia.gov.al Cel: +355688534468
Fier Punonjësi: Adelina Agolli adresa: Këshilli i Qarkut, Kati i I, Fier email: ndihmajuridike.fier@drejtesia.gov.al Cel: +35569 67 66 109	Gjirokastër Punonjësi: Klaudia Veizi adresa: pranë ish Gjykatës të Shkallës së Apelit email: ndihmajuridike.gjirokaster@drejtesia.gov.al Cel: +35569 28 77 376
Durrës Punonjësi: Elisa Zoto adresa: Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës email: "ndihmajuridike.durres@drejtesia.gov.al Cel: +355686022232	Kurbin Punonjësi: Ernest Buna adresa: Pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin email: ndihmajuridikekurbin@drejtesia.gov.al Cel: +35568 56 08 565
Shkodër Punonjësi: Xhevahire Kodra adresa: Rr. Don Bosko, pranë ish Gjykatës, Shkodër. email: ndihmajuridike.shkoder@drejtesia.gov.al Cel: 696376650	Vlorë Punonjësi: Kejda Myzaferaj adresa: Pranë Bashkisë Vlorë email: ndihmajuridike.vlore@drejtesia.gov.al Cel: +35569 54 18 880
Lushnjë Punonjësi: _____ adresa: Pranë gjykatës Lushnje email: ndihma.juridikelushnje@drejtesia.gov.al Cel: _____	Korçë Punonjësi: Marinela Nasi adresa: Pranë ish Gjykatës së Apelit Korçë email: ndihmajuridike.korce@drejtesia.gov.al Cel: +355697654551
Tropojë Punonjësi: Almona Memia adresa: Pranë ish Gjykatës, Tropojë email: ndihmajuridiketropoje@drejtesia.gov.al Cel: +35568 28 09 922	Lezhë Punonjësi: Dorela Menga adresa: Pranë Bashkisë Lezhë email: ndihmajuridike.lezhe@drejtesia.gov.al Cel: +355683663656
Pukë Punonjësi: _____ adresa: Pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë email: ndihmajuridike.puke@drejtesia.gov.al Cel: _____	Dibër Punonjësi: Ajet Iskurti adresa: Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Diber email: ndihmajuridike.diber@drejtesia.gov.al Cel: +35568 43 92 077
Përmet Punonjësi: Fetië Maliqi adresa: Pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet email: ndihmajuridike.permet@drejtesia.gov.al Cel: +33568 28 87 180	Berat Punonjësi: Bajram Myftiu adresa: Zyra me nje ndalese, Bashkia Berat email: ndihmajuridike.berat@drejtesia.gov.al Cel: +355696001214
Mat Punonjësi: Artan Ballabani adresa: Pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat email: ndihmajuridike.mat@drejtesia.gov.al Cel: +355694113328	Kukës Punonjësi: Ardit Koldashi adresa: Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës email: ndihmajuridike.kukes@drejtesia.gov.al Cel: +355695629188

Pogradec Punonjësi: _____ adresa: Bulevardi “Rreshit Collaku”, Lagja 2 email: ndihmajuridike.pogradec@drejtesia.gov.al Cel: _____	Kavajë Punonjësi: _____ adresa: Pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë email: ndihmajuridike.pogradec@drejtesia.gov.al Cel: _____
--	--

Personat e kontaktit për secilën zyrë të punësimit të AKPA-s:

Tiranë Përgjegjës sektori: Klotilda Koka adresa: Zyra e Punësimit Tiranë email: klotilda.koka@akpa.gov.al Cel: +355698666771	Durrës Përgjegjës sektori: Majlinda Mema adresa: Zyra e Punësimit Durrës email: majlinda.mema@akpa.gov.al Cel: +355 692350322
Fier Përgjegjës sektori: Suela Sinani adresa: Zyra e Punësimit Fier email: suela.sinani@akpa.gov.al Cel: +355696538358	Dibër Përgjegjës sektori: Klodian Pershaku adresa: Zyra e Punësimit Dibër email: Klodian.pershaku@akpa.gov.al Cel: +355674703555
Shkodër Përgjegjës sektori: Mimoza Kallaci adresa: Zyra e Punësimit Shkodër email: mimoza.kallaci@akpa.gov.al Cel: +355696414459	Berat Përgjegjës sektori: Jonida Toska adresa: Zyra e Punësimit Berat email: jonida.toska@akpa.gov.al Cel: +355695212900
Gjirokastrë Përgjegjës sektori: Erald Bushi adresa: Zyra e Punësimit Gjirokastrë email: erald.bushi@akpa.gov.al Cel: +355696441942	Kukës Përgjegjës sektori: Miranda Spahiu adresa: Zyra e Punësimit Kukës email: miranda.spahiu@akpa.gov.al Cel: +355685158042
Lushnjë Përgjegjës sektori: Jonis Kapedani adresa: Zyra e Punësimit Lushnjë email: jonis.kapedani@akpa.gov.al Cel: +355673561004	Kavajë Përgjegjës sektori: Erjona Bani adresa: Zyra e Punësimit Kavajë email: erjona.bani@akpa.gov.al Cel: +355694422238
Tropojë Përgjegjës sektori: Arlinda Byberi adresa: Zyra e Punësimit Tropojë email: jonis.kapedani@akpa.gov.al Cel: +355695615115	Elbasan Përgjegjës sektori: Koco Kapurani adresa: Zyra e Punësimit Elbasan email: erjona.bani@akpa.gov.al Cel: +355695310451
Përmet Përgjegjës sektori: Odisela Myrto adresa: Zyra e Punësimit Përmet email: odisela.myrto@akpa.gov.al Cel: +355698665915	Kurbin Punonjës: Naile Hysa adresa: Zyra e Punësimit Kurbin email: naile.hysa@akpa.gov.al Cel: +355685321579
Mat Përgjegjës sektori: Enea Gjyla adresa: Zyra e Punësimit Mat	Vlorë Përgjegjës sektori: Semanuela Qatja adresa: Zyra e Punësimit Vlorë

email: enea.gjyla@akpa.gov.al Cel: +355693435620	email: semanuela.qatja@akpa.gov.al Cel: +355698801362
Pukë Përgjegjës sektori: Ilirjan Lleshi adresa: Zyra e Punësimit Pukë email: ilirjan.lleshi@akpa.gov.al Cel: +355686475737	Korçë Punonjës: Elena Caci adresa: Zyra e Punësimit Korçë email: elena.caci@akpa.gov.al Cel: +355699923128
Pogradec Përgjegjës sektori: Luiza Kreste adresa: Zyra e Punësimit Pogradec email: luiza.kreste@akpa.gov.al Cel: +355695736060	Lezhë Përgjegjës sektori: Mimoza Prenga adresa: Zyra e Punësimit Lezhë email: erjona.bani@akpa.gov.al Cel: +355695827247

Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda 1 (një) jave kalendarike nga data e ndryshimit, mbi të dhënat e personit të ri të kontaktit.

Neni 7

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët.
2. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë 2 vjeçare nga data 21.01.2026 deri më datë 22.01.2028 dhe do të jetë efektive përgjatë këtij afati.
3. Palët mund ta ndërpresin marrëveshjen në çdo kohë duke njoftuar palën tjetër me shkrim, të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara.
4. Aktivitetet që janë në proces në momentin e përfundimit të marrëveshjes, do të përfundojnë në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

Neni 8

Ndryshimet

1. Çdo ndryshim në këtë marrëveshje bashkëpunimi, kryhet vetëm nëpërmjet pëlqimit reciprok të palëve.
2. Palët në vullnetin e tyre iniciojnë ndryshimin e detyrimeve të marrëveshjes së bashkëpunimit sipas nevojave dhe problematikave që hasen.
3. Ndryshimet hyjnë në fuqi, pas nënshkrimit të tyre.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

Neni 10

Dispozita të fundit

Kjo marrëveshje nuk është burim i krijimit të detyrimeve monetare dhe financiare ndërmjet palëve.

Çdo palë merr përsipër të përmbushë detyrimet sipas kësaj marrëveshjeve pa pretendim financiar ndaj palës tjetër.

Kjo marrëveshje mirëkuptimi hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

**PËR DREJTORINË E NDIHMËS
JURIDIKE FALAS**

**Drejtori i Përgjithshëm
(Në mungesë)**

Drejtori i Drejtorisë së Zbatimit të Politikave
dhe Administrimit të Ndihmës Parësore

Patricia POGAÇE

**PËR AGJENCINË KOMBËTARE
TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

**Drejtori i Përgjithshëm
Klevis HYSA**